

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6691
E hënë, 29 gusht 2022
çmimi 0.40

Fillojnë "Ditët e Nënë Terezës" FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMENTOHET NË MËNYRA TË NDRYSHME ARRITJA E MARRËVESHJES PËR DOKUMENTET NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

ANALISTËT: ASOCIACIONI, TEMË E RËNDË POLITIKE



Njohësit e proceseve politike në vend, Valon Murati dhe Ismet Kryeziu, kanë thënë se, pas arritjes së marrëveshjes për dokumentet në mes të Kosovës dhe Serbisë, në ditët e ardhshme pala e Kosovës do ta ketë të paalternativë fillimin e zbatimit të marrëveshjes për asociacionin. Sipas tyre, kjo do të

jetë një temë e rëndë politike për delegacionin e Kosovës. Ndërkaq nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka theksuar se është nevojë urgjente që të zhvillohet një dialog i brendshëm për këtë proces me pjesëmarrje të pozitës, të opozitës dhe të shoqërisë civile

AKTUALE



BE-ja PRITET TA PEZULLOJË MARRËVESHJEN PËR VIZA ME RUSINË F. 2

ODA EKONOMIKE AMERIKANE: BIZNESET PO HUMBIN MILIONA EURO NË DITË NGA SHKURTIMET E RRYMËS F. 7

KAPEN PAJISJE ILEGALE TË KRIPTOVALUTAVE NË PODUJEVË F. 6

EKONOMI



BIE NJËSIA 'A3' NË KEK, PËRKEQËSOHET SITUATA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE F. 7

MINISTRI PEÇI THOTË SE KANË SUBVENCIONUAR MBI 16 MIJË FERMERË F. 7

SPORT



PRISHTINA FITON NË PODUJEVË, DRITA NDAHET BARAS ME FERIZAJN F. 10



INFEKTIVJA E GATSHME PËR ÇDO VALË TË RE TË VIRUSIT

FAQE 5



KURTI PËR KRIZËN ENERGETIKE: ËSHTË MIRË TË KURSEJMË FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja pritet ta pezullojë marrëveshjen për viza me Rusinë

BRUKSEL, 28 GUSHT - Ministrat e Bashkimit Evropian pritet që ta mbështesin pezullimin e një marrëveshjeje të vitit 2007 me Moskës që u jep trajtim preferencial kërkesave të rusëve për viza, raporto i "Financial Time", duke cituar zyrtarë anonimë të përfshirë në bisedime. Këto raportime më 28 gusht vijnë teksa shtetet lindore të bllokut kanë kërcënuar se në mënyrë të njëanshme do t'i mbyllin kufijtë për turistët rusë teksa pushtimi i paprovokuar rusi Ukrainës po vazhdon.

Ministrat e BE-së pritet ta japin mbështetjen e tyre politike për marrëveshjen për lehtësimin e vizave BE - Rusi gjatë takimit dyditor në Pragë, që nis më 30 gusht, thanë për "Financial Times" tre zyrtarë të përfshirë në bisedime. "Është e papërshtatshme që turistët rusë të bredhin nëpër qytetet tona, në portet tona", tha një zyrtar i lartë i BE-së, i përfshirë në bisedime. "Ne duhet të dërgojmë një sinjal te populli rus se lufta nuk është në rregull, nuk është e pranueshme". Pjesë të marrëveshjes për

lehtësimin e vizave të vitit 2007 me Moskës që lidhen me lëvizjen e lirë të zyrtarëve qeveritarë dhe biznesorë, janë pezulluar pak kohë pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Financial Times raporto i se një pezullim më i gjerë i marrëveshjes do të hiqte trajtimin preferencial për rusët që aplikojnë për të gjitha vizat e vendeve të BE-së. Rusët më pas do të duhej të ofronin dokumente shtesë, duke i bërë vizat më të kushtueshme dhe duke e rritur edhe periudhën e pritjes për marrjen e vizës, raporto i FT. "Ne jemi në një situatë të jashtëzakonshme që kërkon hapa të jashtëzakonshëm. Ne duam të shkojmë përtej pezullimit të lehtësimit të vizave", tha një zyrtar i lartë i BE-së për FT, duke shtuar se ashpërsimi i kriterëve për marrjen e vizave do të prezantohej në fund të vitit.

Disa shtete anëtare kanë kërkuar veprime që do t'iu pamundësonin rusëve të zakonshëm që të udhëtonin në BE me viza turistike. Këto masa janë kërkuar me qëllim të ndëshkimit të Moskës. Republika Çeke dhe Polonia



ndaluan lehtësimin e vizave për turistët rusë pak kohë pas nisjes së pushtimit të Ukrainës.

Këto dy shtete kanë qenë të zëshme në kërkesën që BE-ja të prezantojë një ndalesë të plotë, diçka që edhe presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka kërkuar nga blloku evropian.

Polonia dhe shtetet e Baltikut që kufizohen me Rusinë kanë sugjeruar se janë të gatshme që të ndalojnë rusët e pajisur me viza turistike që të hyjnë në territoret e tyre, duke u thirrur në përjashtimet e sigurisë kombëtare që përmban marrëveshja e Shengenit. Finlanda që ndan një kufi prej

1.335 kilometrash me Rusinë gjatë këtij muaji tha se nga 1 shtatori do të reduktojë për 90 për qind vizat që do të lëshojë për turistët rusë. "Vizat turistike nuk do të ndalohen plotësisht, por numri i këtyre llojeve të vizave që do të lëshohen, do të reduktohet ndjeshëm", tha për gazetaret, ministri i Jashtëm i Finlandës, Pekka Haavisto. "Kjo nënkupton se llojet e tjera të vizave - vizat për familjarët, vizat për vizita të familjarëve, për punë dhe studime - do të duhet më shumë kohë dhe kriterë që të lëshohen", tha ai. Sipas transmetuesit publik, Yle, Finlanda shqyrton rreth 1.000 aplikime për viza nga rusët në

ditë.

Megjithatë, nuk ka pasur konsensus në mesin e 27 shteteve anëtare për këtë çështje dhe disa shtete kanë vazhduar të lëshojnë viza turistike, duke iu mundësuar rusëve që të udhëtojnë në gjithë zonën Shengen.

Kancelari gjerman, Olaf Scholz, është pajtuar se është e rëndësishme që të sanksionohen personat e afërt me presidentin rus, Vladimir Putin. Por, ai ka thënë se evropianët "duhet ta kuptojnë se ka shumë njerëz që po largohen nga Rusia sepse ata nuk pajtohen me regjimin rus". Ministri i Jashtëm i Lituanisë, Gabrielius Landsbergis, tha se "mezi pres që të gjejmë një zgjidhje të përbashkët evropiane lidhur me atë se si të kufizojmë numrin e turistëve rusë në Evropë". "Por, nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje e përbashkët, ne nuk mund ta përjashtojmë mundësinë e ndonjë marrëveshjeje rajonale midis shteteve që janë më të prekura nga numri i madh i turistëve rusë që abuzojnë me mikpritjen evropiane".

Luftanijet amerikane lundrojnë përmes Ngushticës së Tajvanit



UASHINGTON, 28 GUSHT - Dy luftanije të marinës amerikane kanë lundruar përmes ujërave ndërkombëtare në Ngushticën e Tajvanit më 28 gusht. Ky është operacioni i parë i këtij lloji qëkur kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, vizitoi Tajvanin.

Marina amerikane tha se luftanijet Chancellorsville dhe Antietam janë duke kryer një operacion. Operacione të tilla rëndom zgjasin nga tetë deri në 12 orë dhe monitorohen nga afër nga ushtria e Kinës.

Në vitet e fundit, luftanijet amerikane dhe në disa raste edhe ato të shteteve aleate sikurse Britania dhe Kanadaja në mënyrë rutine lundrojnë përmes Ngushticës së Tajvanit. Këto lundrime nxisin

zemërimin e Kinës e cila pretendon se Tajvani është pjesë e saj, pavarësisht se Qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike në Taipei hedh poshtë këto pretendime të Pekinit.

Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, vizitoi Tajvanin në fillim të gushtit. Vizita e saj nxiti reagimin e ashpër të Kinës, e cila e pa këtë vizitë si ndërhyrje në çështjet e saj të brendshme. Pas vizitës, Kina nisi të kryejë stërvitje ushtarake pranë Tajvanit dhe që atëherë këto stërvitje kanë vazhduar.

Tajvani është ishull vetëqeverisës dhe është ndarë nga Kina në luftën civile të vitit 1940. Mirëpo, Pekini insiston se ishulli do t'i kthehet atij.

Forcat ukrainase vazhdojnë t'i zbrapsin sulmet ruse në Donbas

DONBAS, 28 GUSHT - Forcat ukrainase kanë vazhduar t'i zbrapsin përpjekjet ruse për të depërtuar rreth qytetit strategjik të Bahmutit, teksa Moska po tenton që të shtrijë kontrollin mbi rajonin e Donbasit.

Pasi javë më parë morën Severodonjeckun dhe Lisiçanskun, forcat ruse tani

janë përqendruar në marrjen e Bahmutit.

Ky qytet që vlerësohet se kishte 70.000 banorë para se Rusia të niste pushtimin e paprovokuar më 24 shkurt, ka qenë cak i granatimeve të reja më 27 gusht. Granatime ka pasur edhe në afërsi, në Soldedar dhe Zaitseve, tha ushtria ukrainase.

Në raportin e ushtrisë

ukrainase u tha se kanë arritur të ndalin përparimin rus edhe në dy qytetet e tjera të mëdha, Slllovijansk dhe Kramatorsk.

Ushtria ukrainase po ashtu tha se forcat e saj janë ende duke e mbajtur kontrollin në qytetin Avdijavka, teksa ka arritur të zbrapsë sulmet me artileri dhe ajrore ruse.



Infektivja e gatshme për çdo valë të re të virusit

PRISHTINË, 28 GUSHT - Drejtori i Klinikës Infektive, Arben Vishaj, ka thënë është vështirë të bëhet parashikimi për valët e reja të Covid-19, por klinika është e gatshme çdoherë për ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, doktor Vishaj ka folur edhe për pasojat afatgjatë duke shtuar se pacientët kanë manifestuar formën më të rëndë në mushkëri. “Këtë valë nuk e kemi pasur shumë të ashpër. Tash valët që vijnë në vijim varet prej situatës se si do të zhvillohet. Sigurisht se është vështirë të bëhet një

parashikim, por gjithsesi ne jemi të gatshëm për çdo valë që vjen të ofrojmë shërbime. Pasojat afatgjatë varësisht prej formës që ka manifestuar pacienti. Kemi pacientë që kanë manifestuar formë shumë të rëndë në dëmtim të mushkërive dhe këta në të ardhmen mund të zhvillojnë shkallë të dëmtimit të mushkërive, fibroza ose kemi pacientë që kanë pasur dëmtim të enëve gjakut dhe janë detyruar t’u amputohet këmba”, tha ai.

Ai u shpreh se nuk mund të thuhet se kur do të kalojë

plotësisht kjo gjendje. “Për momentin pasojat afatgjatë të Covid-it në përgjithësi ekzistojnë dhe ato janë të pranishme në mesin e pacientëve tanë. Se kur do ta kalojmë këtë gjendje është vështirë të japim prognozë por, sido që të jetë, duket që valët me ngadalë po janë me një ashpërsi më të vogël dhe po është më e lehtë të menaxhohen valët që i kemi pasur”, tha Vishaj.

Ndërsa për linë e majmunëve, Vishaj tha se nuk kanë të dyshuar me këtë rast, ani pse e ka përfshirë tërë rajonin,



raporton EO. “Për momentin nuk kemi rast të dyshuar sa i përket lisë së majmunëve. Është e vërtetë se edhe në rajon ka pacientë më këtë

sëmundje, por jemi duke e përcjell edhe këtë situatë dhe nëse vjen, jemi të gatshëm ta ofrojmë shërbimin e duhur”, ka thënë ai.

5 000 maturantë morën pjesë në afatin e dytë të provimit të maturës



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 GUSHT - Është mbajtur afati i dytë i Provimit të Maturës Shtetërore i organizuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI). Në këtë afat kanë marrë pjesë rreth 5 000 maturantë, të cilët nuk e kanë arritur pragun e kalueshmërisë në afatin e parë.

Provimi është organizuar në 59 qendra të testimit, ndërsa në këtë proces janë angazhuar 177 komisionarë, 70 mbikëqyrës, 50 vëzhgues, si dhe 600 administrues. Të gjitha qendrat e testimit janë

monitoruar edhe nga Këshilli Rinor Kosovar (KYC). Sipas informatave të para të komisioneve, provimi ka filluar dhe ka përfunduar në kohën e caktuar dhe çdo gjë ka shkuar sipas planit dinamik të punës. Në ato raste ku janë evidentuar parregullsi janë marrë masa që parashihen me Ligjin e Maturës si ndaj administruesve, ashtu edhe ndaj nxënësve.

MASHTI i ka falënderuar të gjithë të përfshirët në këtë proces për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre.

Rezultatet e Provimit të Maturës Shtetërore për afatin e dytë pritet të publikohen më së largu më 7 shtator.

Fillojnë “Ditët e Nënë Terezës”

PRISHTINË, 28 GUSHT - Me akademinë solemne të organizuar në ditëlindjen e Shën Nënë Terezës, u hapën ditët me aktivitete kushtuar asaj, “Ditët e Nënë Terezës”. Në këtë ngjarje që u mbajt në Qendrën “BogdaniPolis” në Katedralen Nënë Tereza morën pjesë përfaqësues të institucioneve të Kosovës, ministra, deputetë, përfaqësues të Ipeshkvisë së Kosovës dhe qytetarë. Në fjalën e tij, Ipeshkvi i Kosovës, imzot Dodë Gjergji, tha se Nënë Tereza nuk është fizikisht në mesin tonë, por veprat e saj duhet t’i kujtojmë secili, t’i ngajmë asaj në përpikëri, në dashuri,

sakrificë dhe në punë.

Ngjarja vazhdoi me një program të pasur artistik. Të pranishmit patën rastin të dëgjojnë Valsin Hyjnor - Himni i Shën Nënë Terezës, të kompozuar nga Lorenc Antoni dhe Genc Tukiqi, të interpretuar nga sopranoja Arta Jashari, e shoqëruar në piano nga Pranvera Hoxha. Po ashtu, performancën me kitarë nga Genc Krasniqi.

Në kuadër të “Ditëve të Nënë Terezës” do të mbahen aktivitete të shumta edukuese, kulturore, ekspozita dhe homazhe, që do të mbarojnë më 5 shtator me koncertin e Filarmonisë së Kosovës.



Dy të vdekur dhe 89 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë vdekur dy

persona dhe janë konfirmuar 89 raste të reja me Covid. 302 persona janë shëruar nga

ky virus në 24 orët e fundit. Raste aktive me Covid janë 1 685. Sipas raportit të datës 28 gusht të ShSKUK-së, 25

pacientë me Covid-19 po trajtohen në klinikat e QKUK-së dhe në spitalet e përgjithshme.





KOMENTOHET NË MËNYRA TË NDRYSHME ARRITJA E MARRËVESHJES
PËR DOKUMENTET NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

Analistët: Asociacioni, temë e rëndë politike

Njohësit e proceseve politike në vend, Valon Murati dhe Ismet Kryeziu, kanë thënë se, pas arritjes së marrëveshjes për dokumentet në mes të Kosovës dhe Serbisë, në ditët e ardhshme pala e Kosovës do ta ketë të paalternativë fillimin e zbatimit të marrëveshjes për asociacionin. Sipas tyre, kjo do të jetë një temë e rëndë politike për delegacionin e Kosovës. Ndërkaq nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka theksuar se është nevojë urgjente të zhvillohet një dialog i brendshëm për këtë proces me pjesëmarrje të pozitës, të opozitës dhe të shoqërisë civile

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 GUSHT - Kosova dhe Serbia janë pajtuar të heqin dorë nga lëshimi i dokumentit për hyrje-dalje për shtetasit e të dy vendeve. Pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, krerët në Kosovë kanë thënë se reciprociteti është thelbi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ndërkaq zyrtarët serbë kanë nënvizuar se kjo marrëveshje nuk nënkupton njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia.

Kjo marrëveshje nënkupton se Serbia, pas 11 vjetësh, do të ndalë së lëshuari dokument për hyrje-dalje për shtetasit e Kosovës kur ata hyjnë në territorin e saj.

Kosova, më 1 gusht, për disa orë lëshoi dokumente të tilla, por vendimi u përcoll me barrikada nga serbët në veri të Kosovës. Pasi ata i hoqën barrikadat, qeveria në Prishtinë e shtyu vendimin për 1 shtator. Ndërkaq, për çështjen tjetër, atë të targave, palët ende nuk kanë marrëveshje dhe ky vendim pritet të hyjë në fuqi më 1 shtator.

Deri te marrëveshja për dokumentet erdhi pas angazhimit të diplomatëve evropianë dhe amerikanë të cilët kërkuan nga palët që të arrijnë një ujdje dhe ta shmangin dhunën në veri të Kosovës.

Shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, ka thënë se kjo marrëveshje do të mundësojë që qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë të lëvizin me letërnjoftimet përkatëse. “Në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, Serbia është pajtuar t’i heqë dokumentet për hyrje-dalje për qytetarët me letërnjoftime të Kosovës dhe Kosova është pajtuar të mos lëshojë dokumente të tilla për qytetarët që posedojnë karta të identitetit të Serbisë. Serbët e Kosovës, por edhe të gjithë qytetarët, do të mund të lëvizin lirshëm në mes të Kosovës dhe Serbisë duke përdorur letërnjoftimet e tyre. BE-ja sapo ka marrë garanci nga kryeministri Kurti për këtë çështje”, ka shkruar ai në “Twitter”.

Sipas Borrellit, kjo ishte një zgjidhje evropiane.

Më pas, përmes një video-mesazhi, Borrelli ka thënë se kjo marrëveshje është në interes të qytetarëve të të dyja shteteve. “Dua t’i falënderoj të dy liderët që e arritën marrëveshjen, në veçanti presidentin Vuçiq që ka treguar përgjegjësi për lidhshmëri”, ka thënë ai. Borrelli i ka falënderuar edhe Shtetet e Bashkuara për mbështetjen dhe ka shtuar se puna për lirinë e lëvizjes ende “nuk ka përfunduar”. “Ka ende probleme të pazgjidhura. Pres nga dy liderët që të vazhdojnë të tregojnë pragmatizëm dhe konstruktivitet në mënyrë që të zgjidhet problemi i targave. E kam thënë disa herë, në kohën e luftës në Ukrainë, me sfida që po përballen evropianët, neve në Evropë nuk na duhen probleme të tjera, nuk na duhen më tensione. Na duhen zgjidhje. Na duhet zgjidhje për Ballkanin Perëndimor dhe sot kemi arritur një zgjidhje, por ka ende probleme të pazgjidhura dhe ne duhet të vazhdojmë të punojmë për t’i zgjidhur ato”, ka deklaruar Borrelli.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se me marrëveshjen e arritur do të mundësohet që qytetarët e Kosovës dhe ata të Serbisë të mund të kalojnë “pa pengesa” pikëkalimet kufitare midis dy shteteve. “Fryma e bisedimeve parimore e të barabarta në Bruksel është reciprociteti. Zgjidhjet normalizuese duhet ta kenë reciprocitetin përbrenda, teksa marrëdhëniet e mira fqinjësore e nënkuptojnë atë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Kurti i ka falënderuar zyrtarët e BE-së, Borrellin dhe Lajçakun, por edhe emisarin amerikan, Escobar dhe ambasadorin amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, për angazhimin dhe kontributin e dhënë për arritjen e kësaj marrëveshjeje.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se Serbia ka arritur të nxjerrë më të mirën e mundshme nga marrëveshja me Prishtinën, duke shtuar se marrëveshja për dokumentet është një ujdje verbale.

Pasi ka vëzhguar stërvitjen e


përbashkët të policisë dhe ushtrisë në poligonin Pasullanksa Livada, Vuçiq u ka thënë gazetarëve se marrëveshja për dokumentet e hyrje-daljes është verbale sepse është marrëveshje e nënshkruar më 2011 në kuadër të dialogut në Bruksel. “[Për shkak se marrëveshja veç është e nënshkruar] Nuk ishte e vështirë, ishte e lehtë për të gjithë”, ka thënë Vuçiqi. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka falënderuar ShBA-në dhe BE-në për mbështetjen e tyre për arritjen e kësaj marrëveshjeje, duke shtuar se reciprociteti nënkupton barazi. “Liria e lëvizjes është themeli i shoqërive demokratike dhe i vlerave evropiane. Republika e Kosovës çdo ditë e më shumë po kontribuon për paqe dhe stabilitet”, ka shkruar ajo në “Facebook”. Osmani ka shtuar se Kosova do ta vazhdojë angazhimin e saj “drejt njohjes reciproke”. Edhe zyrtari i lartë i PDK-së, Betim Gjoshi, ka shkruar në “Facebook” për arritjen e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku të dyja vendet janë pajtuar që të heqin dorë nga lëshimi i dokumentit për hyrje-dalje për shtetasit e tyre. Gjoshi ka theksuar se Hashim Thaçi është pakrahasimisht përpara politikanëve si Albin Kurti, pa vizion dhe që nuk i

njej historia për asgjë. “Sot Albin Kurti dhe Vetëvendosja po gëzohen shumë që po arrijnë t’i zbatojnë marrëveshjet e Hashim Thaçit”. “Ky nuk është sukses, por mjerim për Kosovën dhe vitet e humbura për shkak të një njeriu - Albin Kurtit”, ka shkruar Gjoshi. Ai ka thënë se për një dekadë i ka mashtruar e gënjyer qytetarët e Kosovës duke u thënë se në Bruksel po nënshkruhen akte tradhtie kundër Republikës së Kosovës. “Kurse sot krenohet duke thënë se asnjë pikë dhe asnjë presje nuk ua heq marrëveshjeve të Hashim Thaçit”, ka deklaruar Gjoshi. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se përafrimi i qëndrimeve të ShBA-së dhe BE-së për marrëveshjen finale Kosovë - Serbi ka krijuar një momentum të ri për procesin i cili duhet të kapitalizohet. Ai ka thënë se në këtë fazë mesazhi është që duhet të ndalet retorika e luftës, retorika që sjell konflikt sepse, sipas Hazirit, jo shpeshherë në proceset politike na ndodh që të krijohen rrethanat politike ku fokusi ndërkombëtar po çon drejt një zgjidhjeje të kërkesave që janë për njohje reciproke, pa opsion tjetër. “Por, fatkeqësisht, Qeveria e Kosovës nuk është e gatshme

për këtë sepse ka pasiguri e mungesë kapacitetesh në këtë përbërje që e ka. Është nevojë urgjente që të zhvillohet një dialog i brendshëm për këtë me pjesëmarrje të pozitës e opozitës dhe shoqërisë civile. Krejt kjo për t’i dhënë oksigjen politik negociatorit, në interes të Republikës”, ka thënë Haziri. Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se pajtimi që të zbatohet një marrëveshje për dokumentet, e arritur qysh në vitin 2011, është një shenjë e mirë e vetëdijesimit se marrëveshjet duhet të zbatohen. Por, sipas tij, është për keqardhje që është dashur të pritet kaq gjatë e të shpenzohet kaq mund e energji për zbatimin e një marrëveshjeje që mundëson lëvizjen e lirë të qytetarëve të të dyja vendeve. “Marrëveshjet një nga një janë strategji e Serbisë për të blerë kohë e për ta vonuar Kosovën. Interesi shtetëror, nacional e qytetar i Kosovës është marrëveshja përfundimtare për njohje, e cila mund të arrihet vetëm me përfshirjen e drejtpërdrejtë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pa ndihmën e së cilës nuk do të fillonte as zbatimi i marrëveshjes për dokumentet e identifikimit. Kanë kaluar njëzet e sa vjet ç’prejse është krijuar një

realitet i ri në Kosovë dhe mbi katërbëdhjetë vjet qysh se Kosova është shpallur shtet sovran dhe i pavarur. Tash është koha e duhur që dialogu të kalojë në një nivel tjetër dhe Serbia ta njohë Republikën e Kosovës”, ka thënë Haradinaj. Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, duke folur për arritjen e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë për dokumentet, ka theksuar se tashmë kemi një qeveri dhe presidencë që pajtohet me formatin, arsyen dhe përmbajtjen e dialogut, marrëveshjet e arritura dhe zbatimin e tyre. “Nga një politikë refuzuese për më shumë se dhjetë vitesh?! Pas ardhjes në pushtet, tani kemi një qeveri dhe presidencë që pajtohet në plotni me formatin, arsyen dhe përmbajtjen e dialogut, marrëveshjet e arritura dhe zbatimin e tyre, si përgjegjësi që derivojnë nga ky proces” ka shkruar Kryeziu në “Facebook”. Ai ka paralajmëruar se në javët në vazhdim pala e Kosovës do ta ketë të paalternativë fillimin e zbatimit të marrëveshjes për asociacionin. Profesori universitar, Valon Murati, ka thënë se asociacionin e kemi të dera. “Tani në rend të ditës do të

vijnë edhe temat e rënda politike për Kosovën, e sidomos ajo e zbatimit të marrëveshjes së asociacionit. Këtë e paralajmëroi edhe emisari special i ShBA-së, Eskobari dhe, si duket, këtë çështje e ka negociuar Vuçiqi më së shumti këto ditë me emisarët ndërkombëtarë. Tani Kosova, përkatësisht qeveria dhe kryeministri Kurti, kanë disa rrugë. E para (të cilën e favorizojnë edhe partitë opozitare) është përpjekja për ta zbatuar marrëveshjen për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe bazuar në Kushtetutën e Kosovës. Ky variant ka gjasa të përkrahet edhe nga bashkësia ndërkombëtare, por kjo nuk do të nënkuptonte as marrëveshje finale e as njohje nga Serbia”, ka thënë Murati. Gjatë javës që lamë pas, Escobari dhe Lajçaku kanë qëndruar në Kosovë dhe Serbi, ku kanë diskutuar me liderët shtetërorë dhe partiakë për çështjen e dokumenteve dhe targave. Ata kanë thënë se palët duhet të zotohen se do ta shmangin dhunën më 1 shtator. Escobari, pas përfundimit të vizitës në Prishtinë dhe Beograd, ka theksuar se të gjitha marrëveshjet duhet të zbatohen në kuadër të dialogut, përshtirë edhe atë të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.



Asociacionin e kemi te dera. Cilat janë opsionet që kemi përpara?



Shkruan: Valon MURATI

Çdo sukcesi të Qeverisë së Kosovës në raport me Serbinë duhet t'i gëzohemi, sigurisht kur zgjidhjet janë të drejta si kjo për pranimin e letërnjoftimeve të Kosovës nga ana e Serbisë pa dokumente shtesë dhe rrjedhimisht mosfutjen në fuqi të masave të njëjta nga ana e Kosovës. Sidoqoftë ende jemi në kornizat e zbatimit të marrëveshjeve prej dialogut teknik të së kaluarës (përfshirë çështjen e targave). Prej fillimit e kam konsideruar se është rrugë krejtësisht e gabuar marrja me tema të vogla, edhe nëse në ndonjë prej tyre shënojnë ndonjë fitore, por duhet të insistohet në bisedime serioze politike për marrëveshjen finale. Por duke qenë se Kryeministri

Kurti e ka ndjekur deri tani rrugën e bisedimeve teknike, dhe për më tepër zbatimin e marrëveshjeve të mëhershme, tani në rend të ditës do të vijë edhe temat e rënda politike për Kosovën, e sidomos ajo e zbatimit të marrëveshjes së asociacionit. Këtë e paralajmëroi edhe emisari special i SHBA-ve Eskobari dhe si duket këtë çështje e ka negociuar Vuçiqi më së shumti këto ditë me emisarët ndërkombëtar. Tani Kosova, përkatësisht qeveria dhe kryeministri Kurti kanë disa rrugë. E para (të cilën e favorizojnë edhe partitë opozitare) është përpjekja për të zbatuar marrëveshjen për themelimin e asociacionit të komunave serbe bazuar në Kushtetutën e Kosovës. Ky variant ka gjasa të përkrahet edhe nga bashkësia ndërkombëtare por kjo nuk do të nënkuptonte as marrëveshje finale e as njohje nga Serbia. Thjeshtë bisedimet për marrëveshjen finale vazhdojnë. Serbia përqendron kërkesat për status special autonom për veriun. Këtë variant kryeministri Kurti e refuzon.

Varianti tjetër është që Kosova të kërkojë bisedime politike për marrëveshje finale me atë që thotë Kryeministri "njohjen në qendër" (diçka e prezantuar nga ai në gjashtë pikat takimit të fundit në Bruksel). Ka gjasa që nëse do të vinte njohja nga Serbia, edhe kryeministri Kurti do të pranonte themelimin e asociacionit. Në këtë variant Serbia e refuzon qasjen dhe insiston në asociacionin si hapi i parë për normalizimin e marrëdhënieve. Në të dy këto variante bisedimet dështojnë dhe gjasat që presioni ndërkombëtar të bie mbi Kosovën është i madh, sidomos për shkak të kërkesës për zbatimin e marrëveshjes për asociacionin. Presioni mund të çojë deri në rënie të qeverisë, sidomos nëse nuk kemi një qasje ofensive të kryeministrit për të ofruar zgjidhje të tjera me Serbinë. Një rënie e tillë e qeverisë duke refuzuar zgjidhje që vërtet mund të jenë problematike për Kosovën mund ta shndërrojë kryeministrin Kurti në një hero populist, por mungesa e

ofrimit të alternativave politike një politikan dhe lider që mendon për vota por jo edhe për zgjidhjen e problemeve. Sidoqoftë gjasat do të ishin të mëdha që në një situatë të tillë prapë të futemi në një cikël qeverish të dobëta dhe mos stabiliteti politik. Asociacioni në të gjitha variantet e tij, ndonëse marrëveshje e nënshkruar nga Kosova është varianti që do ta dëmtonte jashtëzakonisht shumë funksionalitetin e Kosovës. Por për këtë kërkohet dalje nga skemat e deritanishme të bisedimeve dhe mendësisë politike të zgjidhjeve të problemeve me Serbisë dhe të veprohet jo vetëm me kreativitet por edhe me guxim dhe drejtësi. E këtë e mundëson vetëm varianti i tretë. Në këtë variant Kosova dhe qeveria Kurti duhet të kërkojë marrëveshje finale, por jo me njohjen në qendër, por me reciprocitetin në qendër: zgjidhjet për veriun e Kosovës të vlejë edhe për Kosovën Lindore. Kjo do të nënkuptonte një qasje serioze të qeverisë sonë dhe punë po ashtu serioze sidomos me amerikanët për

t'u shpjeguar për vendosmërinë që kemi për një zgjidhje finale të drejtë me Serbinë, duke qenë se ata në vitin 2018 edhe e hapën mundësinë e zgjidhjes së problemit në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes ripërcaktimit të kufijve. Parimi i reciprocitetit në mes të Kosovës Lindore dhe veriut të Kosovës në fund do të dërgonte domosdo në ripërcaktimin e kufijve si zgjidhja më e mirë e problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Edhe këtë variant, duke qenë se jo vetëm e ka kundërshtuar publikisht, por edhe nuk e trajton si zgjidhje populiste, kryeministri nuk do ta shtyjë përpara, duke lëshuar një mundësi të artë që me legjitimitetin dhe forcën politike që ka t'ia heq Kosovës një barrë të rëndë nga shpina në një rënje anë dhe ta zgjidh edhe problemin e shqiptarëve të Kosovës Lindore në anën tjetër. Në këtë kontekst, muaj të rëndë politik po na presin, muaj që mund të përcaktojnë edhe të ardhmen e Kosovës por edhe të dridhin skenën politike në vend.

Kapen pajisje ilegale të kriptovalutave në Podujevë



PRISHTINË, 28 GUSHT - Janë sekuestruar disa pajisje për prodhimin e kriptovalutave. Siç njofton Dogana e Kosovës, këto pajisje janë sekuestruar në Podujevë, ku oficerët kanë kryer një bastisje në një banesë private dhe kanë gjetur mallra pa dokumentacion i cili është i kontrabanduar në

vendin tonë. "Oficerët doganorë me urdhër të organeve kompetente kanë bastisur një objekt banimi në Podujevë ku edhe kanë gjetur mallra ilegale të kontrabanduara. Më saktësisht në Podujevë, oficerët doganor kanë kryer një bastisje në një banesë

private ku dhe kanë gjetur mallra pa dokumentacion i cili është i kontrabanduar në Kosovë. Me këtë rast janë konfiskuar: 23 copë Ant-Miner El 3 dhe 13 shtëpiza 1 st cool", ka njoftuar Dogana. Përpos kësaj, është konstatuar se në vendin e njëjtë kishte edhe vjedhje të rrymës. Sipas konstatimeve

preliminare vjedhja e energjisë elektrike është mbi 40 mijë euro. "Të gjitha pajisjet ishin në funksion për prodhim të kriptovalutave. Me këtë rast përpos mallit të kontrabanduar zyrtarët doganor kanë vërejtur edhe një lidhje të dyshimtë në rrjetin e rrymës elektrike

dhe kane njoftuar edhe zyrtarët e KEDS të cilët kanë dalë në vend të ngjarjes dhe kanë konstatuar se kemi të bëjmë me kycje ilegale dhe vjedhje të rrymës elektrike. Sipas konstatimeve preliminare vjedhje e energjia elektrike është mbi 40.000 mijë euro", ka njoftuar Dogana.

Kurti për krizën energjetike: Është mirë të kursejmë

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur në mbledhjen e 48 të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje edhe për situatën me energjinë elektrike, duke thënë se çmimi është vazhdimisht në rritje.

Kurti ka deklaruar se për të

dalë nga kjo krizë energjetike duhet të kursehet rryma, ndërsa ka bërë me dije se tashmë kanë ndarë 100 milionë euro për ta zbutur ndikimin e rritjes së faturave të energjisë për qytetarët. "Ne tashmë kemi ndarë 100 milionë euro për ta zbutur ndikimin e rritjes së faturave të energjisë për qytetarët, por

çmimi i energjisë është vazhdimisht në rritje, prandaj na duhet një debat i hapur dhe i sinçertë mes nesh mbi gjendjen që jemi dhe sfidën që kemi përpara në mënyrë që gjatë dimrit të fokusohemi në atë që është e mundur e, mbi të gjitha, është kursimi i energjisë", ka thënë Kurti.



Bie njësia 'A3' në KEK, përkeqësohet situata e furnizimit me energji elektrike



PRISHTINË, 28 GUSHT - KOSTT-i ka kërkuar të dielën nga KEDS-i që, si pasojë e rënies nga sistemi të njësies "A3", të bëjë kufizime emergjente të energjisë elektrike. Kjo bën që në vend aktualisht të prodhohen më pak se 400 megavatë, që e bën situatën aspak të favorshme. Sipas një njoftimi të KEDS-it, në

ballafaqim me kufizimet emergjente do të jetë shumë e vështirë të njoftohen të gjithë konsumatorët në kohë, për çfarë kanë kërkuar mirëkuptimin e tyre. "Aktualisht kufizimet janë dyorëshe, por që të mos përkeqësohet tutje situata, kërkojmë nga të gjithë konsumatorët kursim

maksimal të energjisë elektrike. Përdorimi i saj në mënyrë eficiente bën që të gjithë të kemi energji elektrike më tepër. Në këto rrethana të vështira duhet të veprojmë të bashkuar në mënyrë që t'i kapërcejmë ato sa më lehtë. Së bashku mund t'ia dalim", ka njoftuar KEDS-i.

Ministri Peci thotë se kanë subvencionuar mbi 16 mijë fermerë

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), Faton Peci, në një konferencë për medie, ka njoftuar të dielën se për një periudhë dyjavore kjo ministri ka proceduar për pagesë gjithsej 24.9 milionë euros për bujqit përfitues në kuadër të Programit për Pagesa Direkte 2022/Subvencione. Peci ka deklaruar se nga mjetet e ndara nga subvencionet kanë përfituar 16 mijë e 593 aplikues. Ai ka bërë me dije se edhe në vijim do të vazhdohet me procesimin e mjeteve për përfituesit e tjerë në kuadër të këtij programi. Gjithashtu, ministri Peci ka njoftuar se është mbyllur periudha e aplikimit për Programin për Zhvillim Rural /Grante në bujqësi në vlerë mbi 26 milionë euro dhe nga mesi i javës së ardhshme "do të



fillojnë procesin e vlerësimit të projekteve". "Duke pasur për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të projekteve të granteve,

MBPZhR-ja në bashkëpunim me CIVIKOS-in ka hapur thirrjen për anëtarë të shoqërisë civile, të cilët do ta monitorojnë këtë proces. Thirrja është e hapur deri më 31 gusht,

andaj ju ftoj që të bëheni pjesë e këtij procesi, për të mbrojtur e garantuar kështu vlerësimin meritore për të gjithë të involvuarit në proces. MBPZhR-ja përmes njoftimeve të shumta për


kultivuesit e grurit ka bërë thirrje që dëshmia për sasinë e dorëzuar të grurit dorëzohet në drejtoritë komunale për bujqësi në komunat përkatëse deri më 02 shtator 2022 në ora 16:00. Pagesa për këtë kategori, në vlerë prej 0.03 euro/kg, do të realizohet pas kësaj date si pagesë e veçantë për të gjithë aplikuesit të kulturës së grurit që dëshmojnë sasinë e dorëzuar të grurit, bazuar në kriteret e parapara me Programin e Pagesave Direkte 2022, konkretisht Udhëzimin administrativ nr. 02/2022. Vlen të theksojmë se thirrja për aplikim për gjashtëmujorin e parë për qumështin sipas cilësisë, thirrjet e raportuara, akuakulturë dhe e vëçave për majmëri ka përfunduar me datë 19.08.2022 dhe numri total i aplikuesve është 1 414 fermerë", ka thënë Peci.

Oda Ekonomike Amerikane: Bizneset po humbin miliona euro në ditë nga shkurtimet e rrymës

PRISHTINË, 28 GUSHT - Shkurtimet me energji elektrike të cilat po aplikohen tash e dy javë në vendin tonë, po u shkaktojnë humbje të mëdha financiare bizneseve dhe prodhuesve vendorë. Drejtues të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) i kanë kritikuar institucionet e vendit për mosveprim për përmirësimin e furnizimit të rregullt me energji elektrike. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se si pasojë e reduktimeve të

energjisë elektrike të paparalajmëruara për bizneset, dëmet financiare nëpër fabrika kapin shifra milionëshe vetëm brenda një dite. Zeka në një intervistë për "Kosovapress" ka folur edhe për ngecjet e institucioneve për realizimin e investimeve kapitale dhe për mosshpenzimin e mjeteve buxhetore. Ai ka thënë se viti 2022 do të jetë vit i humbur për nga ndikimi i investimeve kapitale pasi, siç ka tregua ai, nuk ka pasur realizim të

investimeve dhe shpenzim të mjeteve buxhetore. Më tutje, ai ka bërë me dije se në takimin me zëvendësndihmëssekretarin amerikan të shtetit amerikan, Gabriel Escobar, diskutimi është përqendruar te rëndësia e integritimit ekonomik të rajonit të Ballkanit Perëndimor, në krijimin e një tregu të përbashkët rajonal, siç është iniciativa për Ballkanin e hapur. Ai ka thënë se OEAK-u e mbështet iniciativën për Ballkanin e hapur.



Pse po ndërhyt Rusia në fushatën elektorale në Itali?



Nga Gianluca DI FEO

Një mendim i shkëlqyer. Për Kremlinin krijimi në Itali i një qeverie më pak të ashpër ndaj Ruisë, është më shumë sesa thjesht një dëshirë. Ajo përfaqëson një objektiv strategjik për t'i dhënë fund izolimit të saj ndërkombëtar të shkaktuar nga pushtimi i Ukrainës.

Siç ka ndodhur prej muajsh, ish-presidenti dhe ish-kryeministri rus Dimitri Medvedev po u bën jehonë projekteve të skifterëve të politikës italiane. Mario Dragi rezultoi të ishte një surprizë e hidhur për Moskën, e cila i dha Italisë një shtysë të fortë atlantiste dhe u pozicionua në krahun e linjës së ashpër evropiane ndaj Moskë dhe në mbështetje të Kievit.

Ekzistenca në Romë e një qeverie shumë më pak amerikësore, mund t'i ofrojë Ruisë mundësinë për të krijuar një të çarë vdekjeprurëse tek kompaktësia aktuale e BE-së. Dhe nga këndvështrimi i Kremlinin, koalicioni i qendrës

së djathtë ofron kredencialet perfekte.

Silvio Berlusconi mbetet i vetmi njeri në Itali që e cilëson Vladimir Putin një mik personal, një parakusht ky themelor për çdo marrëdhënie politike. Po ashtu, "Il Cavaliere" krenohet me marrëdhëniet e mira që ruan me SHBA-në, dhe në veçanti me figurat e vjetra republikane të epokës së Bush. Por marrëdhënia me Carin e ri të Ruisë ka qenë gjithmonë e thellë, dhe përfshin festat private në vilat e tij luksoze dhe disa biznese mbi të cilat nuk ka shumë informacion. Pasi udhëheqësi i Forza Italia të rikthehet në qeveri, ai mund të jetë bashkëbiseduesi ideal për ambicien më të rëndësishme të Moskës: organizimin e një konference ku të ripërcaktohet ekuilibri i sigurisë në Evropë, duke e njohur rolin e Ruisë si një fuqi e madhe.

Me gjithë përpjekjet e tij, Mateo Salvini nuk arriti asnjëherë të ndërtojë një dialog të drejtpërdrejtë me Putinin. Megjithatë, dihet përkushtimi i tij ndaj kësaj kauze, nga binjakëzimi i Legës me partinë

Rusia e Bashkuar, tek udhëtimi në Krimenë e pushtuar me bluzën famëkeqe me fytyrën e Putinit, dhe deri tek negociatat e errëta të Xhanluka Savoinit për të diskutuar financimin për hotelin Metropol.

Takimet e fundit me ambasadorin rus në Itali, Sergej Razov për të hyrë në një negociatë paqësore së bashku me avokatin Antonio Kapuano, nuk mund të konfirmojnë vetëm predispozitën "dashmirëse" të sekretarit të Legës së Veriut ndaj kërkesave ruse.

Moska e ka më të vështirë të deshifrojë Xhorxhia Melonin, vokacioni atlantik i së cilës duket i vërtetë dhe i rrënjësor, dhe pa asnjë tundim të mëparshëm drejt Lindjes. Por në Kremlin mbajnë shumë shpresa tek zgjedhjet parlamentare të vjeshtës në Itali, kur efekti i krizës ekonomike do ta bëjë më të vështirë ruajtjen e besimit me sanksionet, dhe kur çmimi i gazit do të ketë një ndikim vendimtar në ecurinë e qeverive evropiane.

Cilido që do të jetë drejtues në Palazzo Chigi, do të duhet të

përballet me perspektivën e ngjallur nga Medvedev mbi "shtëpitë e ftohta dhe frigoriferët bosh". Joshja nga energjia e lira, mund të pritët me një qasje të ndryshme nga një ekzekutiv populist.

Ajo çfarë shpresojnë rusët është që Meloni mund të imitojë nesër aleatin e tij, liderin hungarez Viktor Orban, të cilit vazhdojnë t'i japin furnizime gazi shtesë, dhe që ka treguar kokëfortësi në mos-bashkimin e vendit të tij me sanksionet e vendosura nga Brukseli përkundrejt Moskës.


Vëmendja ndaj Italisë nuk është e izoluar, por është një prioritet. Situata në fushën e betejës në Ukrainë e ka bindur Moskën se fitorja nuk mund të arrihet pa ngadalësuar dërgesat e armëve perëndimore në Kiev. Në një luftë rrënuese, sukcesi vjen vetëm me rënien e kundërshtarit.

Por ky mbetet një synim i pamundur në rast se vazhdon dërgimi i sistemeve luftarake perëndimore me cilësi dhe sasi të paparë. Prandaj Moska po i përqendron manovrat e saj në Evropë, me mjete të mira dhe të këqij, duke përdorur furnizimet

me gaz për të shantazhuar Gjermaninë. Duke hedhur në erë magazinat e kompanive bullgare që eksportojnë armë në Kiev. Duke nxitur të reagojnë aleatët e saj serbë në Bosnje dhe Kosovë.

Dëbon trupat evropiane nga Mali; vendos trupa në Sudan; vë në pikëpyetje prodhimin e naftës dhe kontrollin e emigracionit të paligjshëm nga Libia. Edhe operacionet e flotës ruse të vendosur në Mesdhe, të cilat shkuan deri në bllokimin e Adriatikut, synojnë të transmetojnë kërcënimin nga një pasiguri që po gjallon në kufijtë e Bashkimit Evropian.

Mjafton të shohësh një hartë për të kuptuar se si Italia është pika kryesore e këtij komploti. Pasja e një bashkëbiseduesi në Romë, mund t'i ofrojë Putinit çelësin për të përmbysur situatën në Ukrainë. Dhe duhet besuar se Kremlinin nuk do t'i kursejë burime për të arritur rezultatin e dëshiruar. Loja sapo ka filluar, me siguri: ndikimi në rezultatin e zgjedhjeve të 25 shtatorit në Itali është jetik për interesat e Ruisë. / "La Repubblica" – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina fiton në Podujevë, Drita ndahet baras me Ferizajn

PRISHTINË, 28 GUSHT - Prishtina e ka vazhduar serinë e rezultateve pozitive në fillim të këtij edicioni në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra nga kryeqyteti, ka shënuar fitore, të dielën, në stadiumin "Zahir Pajaziti" si mysafire e Llapit, me rezultat 2:1, në kuadër të xhiros së katërt. Për skuadrën e drejtuar nga Ismet Munishi kjo është fitorja e dytë në tri takimet e luajtura deri më tash, ngase ndeshja e javës së tretë me Dritën është shtyrë. Për fitoren e Prishtinës realizuan Kreshnik Uka nga penalltia, në minutën e 14-të dhe Endrit Krasniqi, në minutën e 58-të. Ndërkaq, golin e vetëm për Llapjanët e

shënoi Trimror Selimi, në minutën e 75-të. Në ndeshjen tjetër, Ferizaj - Drita, nuk pati fitues, pasi kjo përballje u mbyll baras 1:1. Drita kaloi e para në epërsi me golin e Besnik Krasniqit, nga penalltia, në minutën e 68-të, teksa një pikë ferizajasve ia siguroi Egzon Shabani, me golin e shënuar në minutën e 85-të, po ashtu nga pika e 11-metërshit. Krejt në fund të ndeshjes Ferizaj shënoi nëpërmjet Ramush Ramadanit, por pas rishikimit të VAR-it goli doli të ishte i parregullt për shkak të pozitës jashtëloje. Gjilani ka vazhduar serinë e rezultateve pozitive, duke shënuar fitore në shtëpi në duel me Trepçen'89, me



rezultat 3:1. Për Gjilanin kjo ishte fitorja e tretë në këtë edicion, krahas një barazimi dhe aktualisht me meritë kryeson renditjen me 10 pikë. Deri te fitorja ndaj skuadrës së rikthyer në elitë, gjilanasit arritën me përmbysje të

rezultatit. Në fakt, mitrovicasit kaluan të parët në epërsi me golin e shënuar nga Christian Mba, në minutën e 8-të. Ndërkohë, shifrat u barazuan në minutën e dytë shtesë të pjesës së parë, kur qendërmbrojtësi Augustin

shënoi autogol. Për 2:1 u përkujdes Elton Cale në minutën e 48-të, ndërsa Mevlan Zeka në minutën e 65-të e vulosi fitoren për skuadrën gjilanasë. Ndërkaq, në ndeshjen tjetër Drenica ka shënuar fitore si mysafire në duel me Malishevën, me rezultat 2:1. Golat për kuqezinjët e Skenderajt i shënuan Arbios Thaqi, në minutën e 30-të dhe qendërsulmuesi Bintsouka Koxy, në minutën e 39-të. E golin e vetëm për Malishevën realizoi Alban Shillova nga penalltia, në minutën e 60-të. Vendasit shënuan edhe një gol krejtësisht në fund të takimit, por pas rishikimit të sistemit VAR ai u shfuqizua.

Superliga e Kosovës ngritët për 6 pozita në renditjen e UEFA-s

PRISHTINË, 28 GUSHT - Pas arritjes historike të Ballkanit, duke u kualifikuar në fazën e grupeve në Ligën e Konferencës, por edhe paraqitjes së mirë edhe të skuadrave tjera në garat evropiane në vitet e fundit, Superliga e Kosovës tashmë është ngjitur për madje 6 vende në renditjen e ligave evropiane. Në rifreskimin e fundit të bërë këtë të diel në

renditjen e UEFA-s për ligat, elita e futbollit tonë zë pozitën e 33-të, duke lënë prapa shumicën e vendeve fqinje por edhe liga tjera evropiane. Rënditja e vendeve të UEFA-s (i njohur edhe si koeficienti UEFA-s) është një renditje e hartuar nga UEFA që e bën të mundur krahasimin e ligave të vendeve të ndryshme. Vlera e një kampionati

llogaritet nga shuma e koeficienteve vjetorë individualë të 5 viteve të fundit. Aktualisht kampionati i Kosovës vlerësohet me 10,291 pikë. Falë kualifikimit në fazën e grupeve Ballkani ka arritur koeficientin 5,5, teksa Drita vlerësohet me koeficientin 1,5, Gjilani është me koeficientin 1 dhe Llapi me koeficientin 0,5.



Verstappeni fiton garën e Belgjikës



BRUKSEL, 26 GUSHT - Një tjetër garë e jashtëzakonshme e kampionit në fuqi të botës në Formula 1. Max Verstappen me Red Bull fitoi sot garën e Çmimit të Madh të Belgjikës, një garë ku piloti holandez u nis nga vendi i 14-të dhe e përfundoi atë i pari. Ai ishte i papërmbyjtshëm në këtë garë, duke bërë një paraqitje të shkëlqyer dhe parakaluar një e nga një të gjithë rivalët. Një fitore që e afron edhe më shumë Verstappen me

titullin kampion, pasi shkëputet edhe më shumë me ndjekësit. I dyti u rendit shoku i tij i skuadrës Sergio Perez, ndërsa në vendin e tretë u rendit Carlos Sainz me Ferrari. Një garë për t'u harruar kjo për Charles Leclerc me Ferrari, që u klasifikua i pesti (u nis nga vendi i 15-të). Ferrari në këtë garë la shumë për të dëshiruar, duke mos qenë në ritmin e Red Bull, shumë e shpejtë. Sainz u nis nga "pole

position", e ruajti kreun në pjesën e parë të garës, por më pas u detyrua të hapë krahun ndaj dy makinave Red Bull, që ishin më të shpejta. Leclerc pati mjaft probleme që në start, duke mos patur ritmin e Verstappen, që ishte shumë i shpejtë. Një garë për t'u harruar kjo për britanikun Lewis Hamilton (Mercedes), që u tërhoq që pas xhiros së parë, pas një aksidenti (Russell i katërti).

Trajneri i Mallorcas me lëvdata për Muriqin

Mallorca, 28 gusht - Trajneri i Mallorcas, Javier Aguirre, ka folur për Vedat Muriqin. Këtë sezon sulmuesi kosovar e ka nisur shumë mirë me

Mallorcan. Në tri ndeshje sa ka zhvilluar, ai ka shënuar dy gola. Mbrëmë ishte vendimtar në fitoren e ekipit të tij ndaj Rayo Vallecanos. E trajneri i

Mallorcas nuk ka kursyer lëvdatat për kosovarin, duke thënë se është në një kohë të mirë. "Muriqi është në një moment të mirë. Ai është i

përkushtuar ndaj ekipit", ka thënë Aguirre. Këtë merkato skuadra spanjolle ka blerë kartonin e kosovarit nga ekipi i Lazios, për 9.5 milionë euro.





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë, 29. 08. 2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32,35. Ligjit të Punës nr. 03/L212, neni 8, dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, shpallë:

KONKURS

- 1 (Një) Këshilltar shkencor për periudhën e mesjetës - zgjedhje/rizgjedhje
- 1 (Një) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën e shek.XIX (osmanolog) – zgjedhje/rizgjedhje
- 1 (Një) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën e shek. XIX-XX – zgjedhje/rizgjedhje
- 1 (Një) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën e shek.XX - zgjedhje/rizgjedhje
- 2 (Dy) Bashkëpunëtor shkencor për periudhën e shek.XX – zgjedhje/rizgjedhje

Kandidatët për Këshilltar shkencor (prof. dr.) duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallen e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku 5 (pesë) punime shkencore në revista relevante ndërkombëtare në kuadër të periudhës së përcaktuar (si autor i parë), të cilat duhet të jenë të njohura sipas Rregullores në fuqi. Së paku dy (2) prej tyre duhet të jenë pas zgjedhjes së fundit
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit
- Të ketë pjesëmarrje me kumtesa së paku në tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) të jetë ndërkombëtare

Kandidatët për Bashkëpunëtor të lartë shkencor (prof.asoc.) duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallen e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku tri (3) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër lemisë, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Të ketë pjesëmarrje me kumtesa së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) të jetë ndërkombëtare

Kandidatët për Bashkëpunëtor shkencor (ass.prof.) duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallen e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë. Punimet duhet të jenë të njohura sipas Rregullores në fuqi.
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj)

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri", Ligjit të Punës nr. 03/L212, dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetatat ditore. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512-303, prej orës 09:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, (Ndërtesa e Arkivit të Kosovës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datum, 29. 08. 2022

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013), Član 30, Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, član 32, 35; Zakon Br. 03/L-212 o Radu, i Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, objaviti:

KONKURS

- 1 (Jedan) Naučni savetnik za srednjovekovni period - izbor/reizbor
- 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za period XIX vekove ((osmanolog) - izbor/reizbor
- 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za period XIX-XX vekove – izbor/reizbor
- 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za period XX vekove – izbor/reizbor
- 2 (Dva) Naučni saradnik za period XX vekove – izbor/reizbor r

Kandidata za naučnog savetnik (Prof.dr.) moraju ispuniti ove uslove:

- Da ima doktorske nauke, za navedeni period.
- Imaju najmanje pet (5) naučnih radova objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima iz odgovarajuće oblasti (kao prvi autor), u skladu sa važećim propisima. Najmanje dva (2) od njih moraju biti nakon poslednjih izbora.
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje
- Da učestvuje sa referatima na najmanje tri konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna

Kandidata za poziciju Viši naučni saradnik (Prof.asoc.) mora ispuniti sledeće uslove:

- Da ima doktorat nauka,
- Imati najmanje tri (3) naučne radove objavljena u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti,
- Najmanje dva (2) od njih moraju biti nakon poslednjih izbora.
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje
- Da učestvuje sa referatima na najmanje dva (2) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna

Kandidata za naučnog saradnika (Ass.dr.) moraju ispuniti ove uslove:

- Da ima doktorske nauke, za navedeni period.
- Imaju najmanje jedan (1) naučnih rad objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti. Radovi moraju biti priznati prema važećim propisima.
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje

Potrebna dokumentacija

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomu za završetak doktorskih studija,
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.)

Izbor osoblja Instituta Istorija " Ali Hadri " bira se u skladu sa odredbama Zakona br . 04 / L - 135 za istraživačke- naučne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri " .

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kandidati izabrani na izornoj listi će biti obavesteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br . Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, (Zgrada Arhiva Kosova).

NJOFTIM

Njoftojmë të klientët se Kompania "ABG Service" SH.P.K. me seli në Suharekë ka marr vendim të shuaj biznesin me Numër Unik Identifikues 811514224 dhe ka caktuar likuiditorin për zhvillimin e procedurës së ikuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte **Kreditore-Debitore** në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin **30 - ditorë** nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamosve klijente da Tvrtka "ABG Service" D.O.O u Suvareka deneo odluku da ugasi biznis po **Jedinstveni Matični Broj 811514224** i ujedno imenovao likfidatora o sprovođenju postuaka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od **30 - dana** objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the Company "ABG Service" L.L.C. based in Suhareka has taken the decision to terminate the business with **Unique Identification Number 811514224** and has appointed the liquidator to conduct the Liquidation procedure. All clients who have **Credit-Debit** reports in this company are notified to be presented within **30 days** from the date of publication in the newspaper.

NJOFTIM

Njoftojmë të klientët se Kompania "ABG Service" SH.P.K. me seli në Suharekë ka marr vendim të shuaj biznesin me Numër Unik Identifikues 811514224 dhe ka caktuar likuiditorin për zhvillimin e procedurës së ikuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte **Kreditore-Debitore** në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin **30 - ditorë** nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamosve klijente da Tvrtka "ABG Service" D.O.O u Suvareka deneo odluku da ugasi biznis po **Jedinstveni Matični Broj 811514224** i ujedno imenovao likfidatora o sprovođenju postuaka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od **30 - dana** objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the Company "ABG Service" L.L.C. based in Suhareka has taken the decision to terminate the business with **Unique Identification Number 811514224** and has appointed the liquidator to conduct the Liquidation procedure. All clients who have **Credit-Debit** reports in this company are notified to be presented within **30 days** from the date of publication in the newspaper.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ PeshterMining J.S.C. SH.A. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810849804.
- ▶ Lulzim Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Drin Alija shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Sinan Thaqi " Zojz.
- ▶ Fatlinda Muca shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Abdul Frashri " Prizren.
- ▶ Ujkan Lila nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.U "Yll Morina" nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Shemsije Emraj shpall të pavlefshme certifikatën shmlt " 11 Marsi " Prizren.
- ▶ Kastriot Ninaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Asad Jusufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Nefit Jusufi " Skorobisht.
- ▶ Merita Mulaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.
- ▶ Alban Gunga nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Mustafa Bakija" Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Leonora Kulludra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Ardian Nikollbibaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, drejtimi teknik i Elektroteknikes.
- ▶ Taulant Ermeni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, XIII dhe diplomën e SH.M. Ekonomike " Kadri Kusari"
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905